

Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2025 për Kapitullin 18: Statistika

Statistikat evropiane zhvillohen, prodhohen dhe diseminohen nga vendet anëtare të BE-së, të udhëhequra nga parimet dhe kriteret e cilësisë të përcaktuara në Rregulloren për Statistikën Evropiane, siç janë pavarësia profesionale, paanshmëria, besueshmëria, disponueshmëria dhe konfidencialiteti statistikor. Janë parashikuar rregulla të përbashkëta për metodologjinë, prodhimin dhe diseminimin e informacionit statistikor, të cilat specifikohen më tej në legjislacionin sektorial që përbën të drejtën e BE-së për statistikat.

Vendi, në fushën e statistikës, ka arritur një nivel **të përgatitjes ndërmjet mesatarës dhe të mirës**. Është shënuar **progres i caktuar**, kryesisht në statistikën e tregut të punës dhe në dorëzimin e të dhënave statistikore në vëllim më të madh. Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk u zbatuan plotësisht dhe mbeten kryesisht të vlefshme. Gjatë vitit të ardhshëm, Maqedonia e Veriut duhet në veçanti:

ta përfundojë punën përgatitore për Regjistrimin e Bujqësisë që duhet të realizohet në vitin 2026; të vazhdojë të sigurojë kuadër dhe burime të mjaftueshme financiare për Entin Shtetëror të Statistikës; të vazhdojë me përmirësimin e statistikave makroekonomike, veçanërisht përmes sigurimit të transparencës së të dhënave statistikore, rritjes së përputhshmërisë, afatshmërisë dhe përfshirjes së procedurës për deficitin e tepërt dhe statistikën financiare të qeverisë, si dhe me harmonizimet e mëtejshme të llogarive financiare dhe llogarive kombëtare tremujore me Sistemin Evropian të Llogarive 2010 (ESA 2010).

Megjithëse infrastruktura statistikore vazhdon në masë të madhe mbetet e harmonizuar me legjislacionin e BE-së, kapacitetet njerëzore të Entit Shtetëror të Statistikës (ESHS) paraqesin një sfidë të rëndësishme për zbatimin e suksesshëm. Transmetimi i të dhënave në Eurostat është përmirësuar gjatë periudhës raportuese, veçanërisht në fushat e Llogarive kombëtare, Statistikave sektoriale dhe Indekseve të çmimeve.

Sa i takon klasifikimeve dhe regjistrave, Klasifikimi Nacional i Veprimtarive (KNV) është përditësuar për t'u harmonizuar me NACE Rev. 2.1 dhe ka filluar të zbatohet nga janari i vitit 2025.

Në fushën e **statistikave makroekonomike**, seritë e llogarive vjetore dhe tremujore janë përditësuar dhe përmirësuar. Llogaritë kombëtare dhe përpilimi i të ardhurave kombëtare bruto (AKB) bazohen në standardet e Sistemit Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Rajonale 2010 (ESA 2010). Enti Shtetëror i Statistikës vazhdoi me dorëzimin e rregullt të të dhënave për AKB dhe PBB tek Eurostat, në kuadër të programit të dorëzimit sipas ESA 2010. Megjithatë, nevojiten përmirësime të mëtejshme, veçanërisht përditësimi i inventarit të AKB-së, që paraqet detyrë të vazhdueshme për ESHS-në. Rekomandimet nga raporti i mëparshëm nuk janë zbatuar, pasi procedura për deficitin e tepërt (EDP) dhe statistikën e financave të qeverisë (GFS) ende nuk janë publikuar.

Statistikat afariste dhe tregtisë vazhdojnë të mbledhen rregullisht, veçanërisht statistikën afatshkurtra për industrinë dhe statistikën strukturore të ndërmarrjeve. Nevojitet punë e mëtejshme për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave dhe raportimin e drejtpërdrejtë për tregtinë ndërkombëtare të shërbimeve.

Sa i përket **statistikave sociale**, saktësia është rritur pas rishikimit të vlerësimeve ndërmjet regjistrimeve të popullsisë, bazuar në rezultatet e regjistrimit të vitit 2021, dhe janë bërë përmirësime edhe në dorëzimin e statistikave të tregut të punës. Është arritur progres i caktuar në lidhje me anketën për të ardhurat dhe kushtet e jetesës (EU-SILC), me përmirësim të transmetimit të të dhënave dhe zbatimin e rekomandimeve dhe udhëzimeve për përgatitjen e anketës.

Sa i takon **statistikave bujqësore**, duhet të përfundohet statistika e integruar e ekonomive bujqësore. Është në vijim përgatitja për realizimin e regjistrimit të bujqësisë në vitin 2026, bazuar në pilot-regjistrimin e vitit 2022.

Në fushën e **statistikave të energjisë dhe mjedisit jetësor**, llogaritë ekonomike të pylltarisë u dorëzuan për herë të parë tek Eurostat.

European Commission 2025 Report on Chapter 18: Statistics

European statistics are developed, produced and disseminated by EU Member States, guided by the principles and quality criteria elaborated in the Regulation on European statistics, such as professional independence, impartiality, reliability, accessibility and statistical confidentiality. Common rules are provided for the methodology, production and dissemination of statistical information, which are further specified in sectoral legislation that constitute the EU acquis on statistics.

The country is between a moderate and a good level of preparation in the area of statistics. Some progress was made, mainly on labour market statistics and the robust transmission of statistical data.

The Commission's recommendations from last year were not fully implemented and remain largely valid. In the coming year, North Macedonia should in particular:

- complete preparatory work for the agricultural census to be conducted in 2026;
- continue ensuring sufficient staffing and financial resources for the State Statistical Office;

→ continue to improve macroeconomic statistics, particularly by making sure that statistics are transparent, increasing the consistency, timeliness and coverage of the excessive deficit procedure and government finance statistics, and by further aligning financial accounts and quarterly national accounts with the European System of Accounts 2010 (ESA 2010).

While the statistical infrastructure continues to be largely aligned with the European acquis, the level of human resources at the State Statistical Office (SSO) poses a significant challenge for efficient implementation. Data transmission to Eurostat has improved during the reporting period, notably in the areas of national accounts, sectoral statistics and price indices.

On classifications and registers, the national standard NACE was updated to align with NACE Rev 2.1 and has started to be implemented since January 2025.

In the area of **macroeconomic statistics**, annual and quarterly accounts series have been updated and improved. National Accounts and the compilation of Gross National Income (GNI) are based on the European System of National and Regional Accounts 2010 (ESA 2010) standards. The State Statistical Office (SSO) has continued the regular transmission of GNI and GDP data to Eurostat under the ESA 2010 transmission programme. However, further improvements are required, particularly the updating of the GNI inventory which poses continuous work for the SSO. The recommendations from the previous report have not been addressed, as the excessive deficit procedure (EDP) and government finance statistics (GFS) are still not published.

Business and trade statistics continue to be collected regularly, especially short-term statistics for industry and structural business statistics. Further work is required to improve data collection and direct reporting on international trade in services.

As regards **social statistics**, accuracy increased following revision of intercensal population estimates based on the 2021 census results, and improvements were made in transmission of labour market statistics. Some progress has been made regarding the survey on Income and Living Conditions (EU-SILC) with improved data transmission and the implementation of recommendations and guidelines for survey design.

On **agricultural statistics**, integrated farm statistics should be completed. Work is ongoing to carry out an agricultural census in 2026, based on a pilot census in 2022.

In the area of **energy and environmental statistics**, forest accounts were transmitted to Eurostat for the first time.